

14/2024



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



Kostoja e pagave jubilarë të papaguara

**(Raport analitik lidhur me ndikimin financiar dhe gjyqësor të
rasteve gjyqësore që përfshijnë pagat jubilarë)**

Autor:

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

dhe

studentët e Klinikës Ligjore të IKD-së: Alban Bytyqi, Anesa Maksuti, Arton Salihi, Aulona Kameri, Auron Demelezi, Fjolla Maksuti, Gent Bunjaku, Jorik Vatovci, Katarina Milenković, Lauresa Gashi, Lazar Jovanović

Raporti është hartuar nën mentorimin e:

Arrita Reznqi, Menaxhere e Programeve/ Hulumtuese e Lartë Ligjore në IKD

Dhe

Prof. Asoc. Mrika Kotorri, RIT në Kosovë

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër, pa lejen e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Ky raport është hartuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe përkrahur nga USAID përmes Projektit për Drejtësi.

Mendimet e shprehura nga autorët në këtë raport nuk përfaqësojnë mendimet e Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Prishtinë,

Shtator, 2024

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
1. Përmbledhja ekzekutive.....	6
2. Metodologjia	7
3. Korniza ligjore që rregullon pagat jubilarë.....	8
4. Trendi i ngarkesës me lëndë gjyqësore nga numri i rasteve të pranuar mbi pagën jubilarë.....	10
4.1. Ngarkesa me lëndë në gjykata lidhur me rastet e pagave jubilarë të pranuar gjatë vitit 2021	11
4.2. Ngarkesa me lëndë në gjykata lidhur me rastet e pagave jubilarë të pranuar gjatë vitit 2022.....	13
4.3. Ngarkesa me lëndë në gjykata lidhur me rastet e pagave jubilarë të pranuar gjatë vitit 2023.....	14
5. Trendi i ngarkesës me lëndë në raport me numrin e banorëve	16
5.1. Gjykata Themelore në Prishtinë.....	17
5.2. Gjykata Themelore në Mitrovicë.....	17
5.3. Gjykata Themelore në Pejë	18
5.4. Gjykata Themelore në Prizren.....	19
5.5. Gjykata Themelore në Ferizaj	20
5.6. Gjykata Themelore në Gjilan.....	21
5.7. Gjykata Themelore në Gjakovë.....	22
6. Analiza e të dhënave të KGJK-së lidhur me rastet e pagave jubilarë.....	23
6.1. Statusi i lëndëve.....	23
7. Analiza e aktgjykimeve në rastet e pagave jubilarë	25
8. Shpenzimet mesatare vjetore lidhur me rastet e pagave jubilarë.....	29
9. Gjetje kryesore dhe konkluzionet:	30
10. Rekomandimet.....	31

Lista e shkurtesave

SMIL	Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Lëndëve
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
LPK	Ligji i Procedurës Kontestimore
LMD	Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare

I. Përmbledhja ekzekutive

Paga jubilarë është një pagë shtesë që u jepet punëtorëve në bazë të Kontratës Kolektive apo ndonjë akti të brendshëm. Kjo pagë jepet për periudha të ndryshme të shërbimit. Baza ligjore për pagat jubilarë është përcaktuar me Ligjin e Punës që përcakton se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj.”* Përderisa ligji përcakton pagën bazë, pagën shtesë dhe beneficionet tjera, Kontrata Kolektive lejon të drejta shtesë si: kompensimi i udhëtimit, shtesat për ushqim dhe kompensime për përvojën e punës, pensionimin dhe pagat jubilarë.

IKD ka gjetur se ngarkesa me lëndë nëpër gjykata ka pasur luhatje ndër vite varësisht prej numrit të lëndëve që lidhen me pagat jubilarë. Viti 2021 konsiderohet si vit kur janë pranuar numri më i madh i lëndëve të pagave jubilarë brenda një viti kalendarik. Përderisa, pas vitit 2021, në vitet pasuese ka pasur ulje të ndjeshme të lëndëve lidhur me pagat jubilarë në raport me numrin total të rasteve civile në procedurën kontestimore. Gjatë vitit 2021, pagat jubilarë përbënin deri në 20% të totalit të rasteve civile në procedurë kontestimore në gjykata, e cila përqindje është ulur në afërsisht 10% gjatë vitit 2022 dhe në 8% në vitin 2023. Përkundër rritjes drastike të numrit të lëndëve të reja në çështjet civile gjatë vitit 2023, përqindja e rasteve të pagave jubilarë në raport me totalin e rasteve civile është ulur.

IKD ka arritur të analizojë dhe të paraqesë të dhënat lidhur me ngarkesën me lëndë në çdo gjykatë, lidhur me rastet e pagave jubilarë në tre vitet e fundit, në raport me numrin e popullsisë në secilin regjion të Kosovës. Mesatarisht në tre vitet e fundit, gati çdo i treqindi (300) qytetar nga regjioni i Prishtinës ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me realizimin e të drejtës në pagë jubilarë. Pasuar nga Mitrovica ku afërsisht çdo i treqind e gjashtëdhjeti (360) qytetar ka iniciuar padi. Në regjionin e Gjilanin për afërsisht çdo i katërqind e njëzet e pesti (425) qytetar ka iniciuar padi për realizimin e të drejtës në pagë jubilarë, përderisa në Prizren çdo i shtatëqind e dyzetë (740) dhe në regjionin e Ferizajt çdo i tetëqind e tetëdhjeti (880) qytetar ka iniciuar padi për pagë jubilarë. Në fund të listës qëndron Peja me çdo të 965-tin qytetar dhe regjioni i Gjakovës më për afërsisht të çdo të 1,050-tin qytetar që ka iniciuar padi në gjykatë për realizimin e të drejtës në pagë jubilarë.

IKD ka analizuar vendimet gjyqësore lidhur me pagat jubilarë, të cilat dëshmojnë se gjykatave u janë nevojitur mesatarisht 690 ditë apo afërsisht dy vite që të vendosin lidhur me këto raste në shkallë të parë. Vendimet e analizuar dëshmojnë se në 70% ta rasteve, paditë janë miratuar plotësisht, në 13% të rasteve paditë janë miratuar pjesërisht dhe në 17% të rasteve paditë janë refuzuar nga gjykatat. Analiza e IKD-së ka vërtetuar se një në 30 raste të analizuar ka qenë subjekt i ekspertizës financiare. Përderisa, paditësit janë përfaqësuar nga avokatët në të gjitha rastet. Avokatët janë angazhuar privatisht nga paditësit. Analiza e IKD ka gjetur se në 80% të rasteve, paditësit kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale në të cilat kërkesa gjykata ka vendosur pozitivisht, duke obliguar palën tjetër, gjithmonë institucionin shtetëror të mbulojë dhe të kompensojë shpenzimet e tilla.

Në bazë të analizës së rasteve, del se shpenzimet vjetore të paguara nga shteti për pagat jubilarë kanë arritur shumën deri në 10 milion Euro.

2. Metodologjia

Përgjatë gjithë programit të Klinikës Ligjore të IKD-së, studentët kanë arritur të identifikojnë disa probleme që sfidojnë sistemin e drejtësisë dhe së bashku me mentorët e tyre vendosën të punojnë në një temë specifike, konkretisht sfidën e realizimit të së drejtës në pagë jubilarë, ngarkesën me këto lëndë të sistemit të drejtësisë, gjithashtu edhe kostot që rrjedhin nga ky proces. Studentët e Klinikës Ligjore të IKD-së, pas përfundimit të njësisë të nevojshme studimore, janë trajnuar për të punuar në analizën e të dhënave, duke i analizuar ato për të gjeneruar një raport gjithëpërfshirës, për të adresuar problemin e identifikuar brenda sistemit të drejtësisë.

Ky raport përfshin analizë të detajuar të të dhënave gjyqësore të mbledhura nga raportet dhe statistikat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), si dhe analiza të legjislacionit të aplikueshëm, instrumenteve dhe akteve të tjera ligjore, që ofrojnë informacionin e nevojshëm lidhur me të drejtat që rrjedhin nga paga jubilarë për qytetarët. Qasja e tillë mundëson një kuptim gjithëpërfshirës të problemit fillestar, procesit gjyqësor, si dhe të pasojave të shkaktuara.

Raporti po ashtu përfshin qasje analitike të tridhjetë rasteve gjyqësore që kanë të bëjnë me pagat jubilarë. Rastet gjyqësore janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Analiza e rasteve gjyqësore shqyrton aspekte të ndryshme të mënyrës së trajtimit, si kohëzgjatja e procedurave, mënyra se si ka përfunduar rasti, nëse është kërkuar ndonjë ekspertizë financiare apo ekspertizë tjetër përfshirë mënyrën e përfaqësimit ligjor (nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, OJQ-të ose avokatët të caktuar privatisht). Raporti përmban po ashtu analizë lidhur me atë nëse secila padi ka përcaktuar kërkesën për shumën e kërkuar për kompensim kundrejt shumës së miratuar nga gjykata, kostot procedurale të pretenduara nga paditësit dhe shumat përkatëse të miratuara nga gjykata.

Për më tepër, raporti ofron një llogaritje të kostove të mbuluara për një rast të pagës jubilarë. Kjo është llogaritur në bazë të të dhënave të gjeneruara nga baza e të dhënave të KGJK-së si dhe në analizën e aktgjykimeve të publikuara nga gjykatat.

Gjatë secilës fazë të hartimit të raportit, studentët e Klinikës Ligjore të IKD-së morën mbështetje të vazhdueshme profesionale nga mentorët e tyre. Kjo mbështetje dhe udhëzimet e ofruara siguruan që analiza ligjore dhe gjetjet të jenë të arritshme për një audiencë më të gjerë, duke përfshirë publikun që nuk ka njohuri apo përvojë lidhur me sistemin e drejtësisë. Në këtë drejtim, gjetjet e raportit janë specifike dhe të qarta, duke synuar të paraqesin një qasje të kuptueshme për të gjithë.

3. Korniza ligjore që rregullon pagat jubilarë

Paga jubilarë është pagë shtesë që i jepet punëtorit në bazë të kontratës kolektive apo ndonjë akti të brendshëm institucional. Kjo pagë jepet për periudha të ndryshme të shërbimit apo punës së kryer nga punëtori.

Për më tepër, paga jubilarë konsiderohet një lloj kompensimi që u jepet punëtorëve si shenjë mirënjohje për kontributin e tyre të vazhdueshëm për organizatën. Qëllimi i pagës jubilarë është të inkurajojë dhe shpërblejë punëtorët për përkushtimin ndaj punëdhënësit, duke shërbyer si motivim për të njëjtit. Paga jubilarë zakonisht jepet si një shumë fikse monetare apo si përqindje shtesë në pagën vjetore të punëtorit.

Baza ligjore e pagës jubilarë është përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-212 e Punës që përcakton se *“i punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit..”*¹ Po ashtu, përcakton se *“të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës..”*² Këto dispozita lejojnë mundësinë për të drejta më të favorshme për punëtorët përmes Kontratës Kolektive.

Për më tepër, Ligji i Punës përcakton se *“Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj..”*³ Kjo nënkupton se Kontrata Kolektive nuk mund të përcaktojë më pak të drejta se sa ato të garantuara me ligj. Përderisa, ligji përcakton pagën bazë, pagën shtesë dhe beneficinet tjera, Kontrata Kolektive lejon për rritjen e drejtave të punëtorëve sikurse shtesat për ushqim, kompensimi për përvojën e punës, kompensimi me rastin e pensionimit dhe pagat jubilarë.

Në Kosovë paga jubilarë është e rregulluar me Kontratën Kolektive të arritur në mes të organizatave të punëdhënësve dhe sindikatave të punëtorëve. Qëllimi i këtyre kontratave është të rregullojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që dalin nga marrëdhënia e punës e arritur sipas Kontratës Kolektive.

Deri më tani disa kontrata kolektive janë nënshkruar, ku në të gjitha këto kontrata kolektive janë përcaktuar dispozitat që përcaktojnë pagën jubilarë. Këto kontrata përfshijnë:

- Kontrata e përgjithshme kolektive e Kosovës (2014).
- Kontrata kolektive e Arsimit të Kosovës (2014 – 2017).
- Kontrata kolektive e Arsimit të Kosovës (2017 – 2021).
- Kontrata kolektive sektoriale (2018 – 2021).

Të gjitha këto kontrata kanë rregulluar çështjen e pagave jubilarë. Me 27 shkurt 2023, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, ka nxjerrë një Mendim Juridik për Shpërblimin jubilar ku është sqaruar baza ligjore lidhur me kontratat e lartcekura. Ky mendim juridik ishte miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme. Sipas arsyetimit të mendimit juridik të Gjykatës Supreme është sqaruar çështja e shpërblimit jubilar në kontratat e lartcekura,

¹ Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, Neni 55, par. 1.

² Po aty, par. 2.

³ Po aty, Neni 4, par. 2.

periudha kohore, kushtet që duhet të aplikohen për marrëveshjen e kontratës kolektive dhe kontratës sektoriale si dhe kushtet për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar.⁴

Po ashtu, Gjykata Supreme me 9 tetor 2023 kishte nxjerrë edhe një Mendim Juridik për zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12 qershor 2018 lidhur me kërkesat e pagës së 13-të të punëtorëve të shëndetësisë. Qëndrimi juridik i Supremes lidhur me këtë çështje ka qenë se Punëtorët shëndetësor në kontestet gjyqësore nga marrëdhëniet e punës me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në këtë kompensim, për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit.⁵

Në po të njëjtën mbledhje në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, pra me 9 tetor 2023 kjo e fundit kishte nxjerrë edhe një Mendim Juridik për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në Policinë e Republikës së Kosovës. Sipas mendimit të Supremes në kontestet nga marrëdhënia e punës lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës jubilarë në bazë të nenit 29 par 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 dhe në bazë të nenit 30 par 5 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, personeli i Policisë ka të drejtë në shpërblimin e pagës jubilarë, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.⁶

⁴Për më tepër shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/8628_Mendim%20juridik%20per%20shperblimin%20jubilar.pdf

⁵ Për më tepër shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/7687_7.%20Mendim%20Juridik-p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20kon.%20kolektive%20sektor.%20lidhur%20me%20k%C3%ABrkesat%20e%20pages%20se%2013%20ne%20sektorin%20e%20shendetesise.pdf

⁶ Për më tepër shih linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/2491_8.%20Mendim%20Juridik%20-%20per%20personelin%20e%20policise,%20shperblimin%20e%20shujtes%20ditore.%20pages%20se%2013-te,%20shtesat%20ne%20page....pdf

4. Trendi i ngarkesës me lëndë gjyqësore nga numri i rasteve të pranuar mbi pagën jubilarë


Ky raport do të fokusohet vetëm në analizimin e të dhënave lidhur me rastet e Pagave Jubilarë në tre vitet e fundit. Sidoqoftë, për të pasur një pasqyrë të pastër lidhur me ngarkesën me punë në gjykata ndër vite, një përmbledhje e përgjithshme mbi çështjet e pagave jubilarë të pranuar në pesë vitet e fundit është paraqitur më poshtë:



Grafika I: Numri i rasteve të pagave jubilarë të pranuar në gjykatat e Kosovës (2019 – 2023)

Në këtë kontekst, është evidente se numri i lëndëve në gjykata ka ndryshuar ndër vite në kuptim të numrit të rasteve të pranuar në baza vjetore. Viti 2021 është viti që ka pranuar më së shumti raste të kësaj natyre. Në kontrast, me vitet 2022 dhe 2023, kur ka pasur ulje të numrit të rasteve të tilla në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, statistikat tregojnë një stabilitet të përgjithshëm lidhur me numrin e rasteve të pagave jubilarë të pranuar, me një rritje të ulët nga vitet 2022 dhe 2023.

Në vazhdimësi të trendit të ngarkesës së rasteve të pagave jubilarë, ka qenë e domosdoshme që në mënyrë të qartë të krahasohet numri i rasteve të pranuar lidhur me pagat jubilarë brenda një viti në krahasim me numrin total të rasteve civile në procedurë kontestimore të pranuar secilin vit. Statistikat dëshmojnë se në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve civile në procedurë kontestimore, ka pasur një ulje të lehtë të numrit të rasteve që lidhen me pagat jubilarë që pranohen brenda një viti.




Grafika 2: Diferenca në mes të rasteve civile dhe rasteve të pagave jubilarë të pranuar për vit kalendarik

Shihet se ka një ulje të dukshme të rasteve të pagave jubilarë në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve civile në procedurë kontestimore në tre vitet e fundit. Gjatë vitit 2021, rastet e pagave jubilarë kanë përbërë deri 20% të numrit të përgjithshëm të rasteve civile në procedurë kontestimore, të cilat kanë rënë deri në 10% gjatë vitit 2022 dhe deri në 8% në vitin 2023. Pavarësisht rritjes së ndjeshme të numrit të përgjithshëm të rasteve civile gjatë vitit 2023, përqindja e rasteve të pagave jubilarë në raport me numrin e përgjithshëm ka shënuar rënie. Kjo mund të reflektohet edhe mbi bazën e faktit se numri i rasteve që lidhen me pagat jubilarë, përqindja e tyre në ngarkesën e përgjithshme të lëndëve zvogëlohet, veçanërisht nëse rritet numri i përgjithshëm i çështjeve civile është rritur.

4.1. Ngarkesa me lëndë në gjykata lidhur me rastet e pagave jubilarë të pranuar gjatë vitit 2021

Ngarkesa e gjykatave që trajtojnë çështjet e pagave jubilarë ka ndryshuar në rajone të ndryshme. Prandaj, të dhënat e mëposhtme do të paraqiten sipas secilit rajonit.

Grafika tregon se në vitin 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë duke përfshirë degët e saj, ka pranuar numrin më të madh të lëndëve që lidhen me paga jubilarë, me gjithsej 3677 raste. Ndryshe nga kjo, Gjykata Themelore në Gjakovë me degët e saj ka pranuar numrin më të vogël të lëndëve të tilla, me vetëm 214, që është përafërsisht 17 herë më pak se në rajonin e Prishtinës.



Grafika 3: Numri i rasteve të pagave jubilarë në gjykata gjatë vitit 2021

Shprehur në përqindje, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degët e saj kanë pasur afërisht gjysmën e lëndëve në punë që lidhen me paga jubilarë gjatë vitit 2021. Në mënyrë specifike, rajoni i Prishtinës ka regjistruar 46% të të gjitha rasteve në nivel kombëtar, pasuar nga rajoni i Mitrovicës me 16%, Ferizaj më 12%, kurse Gjakova me degët e saj ka pasur përqindjen më të ulët me vetëm 3%.




Grafika 4: Përqindja e rasteve të pagave jubilarë në gjykata gjatë vitit 2021

4.2 Ngarkesa me lëndë në gjykata lidhur me rastet e pagave jubilarë të pranuar gjatë vitit 2022

Çdo rajon është ballafaquar me ngarkesa të ndryshme të rasteve të pagave jubilarë, të cilat janë paraqitur në grafikën e mëposhtme. Gjatë vitit 2022, ngjashëm me vitin paraprak, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degët e saj ka pranuar numrin më të madh të lëndëve, gjithsej 1795. Për dallim nga viti paraprak, Gjykata Themelore në Prizren së bashku me degët e saj, kishte vendin e dytë për nga numri i lëndëve, me 678.


Në vitin 2022 Gjykata Themelore në Ferizaj dhe degët e saj kanë pranuar numrin më të vogël të lëndëve, me vetëm 114, që është përafërsisht 15 herë më pak se në rajonin e Prishtinës.



Grafika 5: Numri i rasteve të pagave jubilarë në Gjykata gjatë vitit 2022

Nëse i konvertojmë të dhënat në përqindje, del se për vitin e dytë radhazi, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degët e saj kanë pas në punë afërsisht gjysmën e lëndëve të pagave jubilarë në nivel kombëtar. Në mënyrë më specifike, rajoni i Prishtinës ka regjistruar 48% të rasteve, ndjekur nga Prizreni me 18%, Mitrovica me 12%, kurse Ferizaj ka pas numrin më të ulët të rasteve me vetëm 3%.


Përqindja e rasteve në gjykata gjatë vitit 2022



Grafika 6: Përqindja e rasteve të pagave jubilarë në gjykata gjatë vitit 2022

4.3 Ngarkesa me lëndë në gjykata lidhur me rastet e pagave jubilarë të pranuar gjatë vitit 2023

Gjatë vitit 2023, secili rajon ka pranuar numër të caktuar të rasteve të pagave jubilarë. Një trend interesant u shfaq në vitin 2023 – për herë të parë, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degët e saj nuk pranuan numrin më të madh të rasteve të pagave jubilarë. Në vend të kësaj, të dhënat tregojnë se në vitin 2023, Gjykata Themelore në Mitrovicë, së bashku me degët e saj, kryesonte listën me 1216 lëndë të pranuar. Për të pasuar me Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saj, me 1017 lëndë. Gjykata Themelore në Prishtinë dhe degët e saj u rendit e treta, me 970 lëndë. Numri më i vogël i lëndëve është regjistruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe degët e saj, me gjithsej 84 lëndë – rreth 15 herë më pak se në rajonin e Mitrovicës që kishte numrin më të madh të lëndëve të pranuar në vitin 2023.



Grafika 7: Numri i rasteve të pagave jubilarë në gjykata gjatë vitit 2023

Përqindja e ndarë për vitin 2023 tregon një ndarje më të balancuar, veçanërisht në tre rajonet më të ngarkuara. Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj kryesojnë me 315 të totalit të lëndëve në nivel kombëtar, ndjekur nga Gjilani dhe Prishtina me nga 26% dhe 24% secila. Në të njëjtën kohë, Peja kishte të regjistruara vetëm 3% të rasteve dhe Gjakova numrin më të vogël të përqindjes së rasteve të pranuar me vetëm 2% gjatë vitit 2023.



Grafika 8: Përqindja e rasteve të pagave jubilarë në gjykata gjatë vitit 2023

5. Trendi i ngarkesës me lëndë në raport me numrin e banorëve

IKD ka analizuar dhe paraqitur të dhënat lidhur me ngarkesën me lëndë në secilën gjykatë me rastet e pagave jubilarë gjatë tri viteve të fundit. Ky kapitull analizon ngarkesën e gjykatave në raport me numrin e popullsisë së secilit rajon. Për të pasur një krahasim kuptimplotë, të dhënat paraqiten për 100,000 banorë, duke siguruar një matje të standardizuar që përputhet me madhësinë e popullsisë së çdo rajoni.

Është me rëndësi të përmendet se këto llogaritje janë të bazuara në ndarjen rajonale të përdorura për qëllime të gjykatës dhe jo ndarje të përdorura për qëllime të administratës komunale. Lidhur me këtë Ligji për Gjykatat përcakton se Gjykatat Themelore janë gjykata të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Shtatë (7) Gjykata Themelore janë si në vijim:

- Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë vepron për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Glogocit dhe të Graçanicës.
- Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan vepron për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenices, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Klllokotit dhe Vërbocit.
- Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren vepron për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës.
- Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë vepron për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit.
- Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë vepron për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës.
- Gjykata Themelore e Ferizajit me seli në Ferizaj vepron për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit.
- Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë vepron për territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë.⁷

Përderisa të dhënat lidhur me numrin e banorëve për secilin rajon të komunave të lartpërmendura janë mbledhur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).⁸


⁷ Ligji Nr. 06/I-054 për Gjykatat, neni 9, par. 2.

⁸ Per me shume informata, Ju lutem shikoni linkun: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Population>.

5.1. Gjykata Themelore në Prishtinë

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunat që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që janë Prishtina, Fushë Kosova, Obiliqi, Lipjani, Podujeva, Gllgovci dhe Graçanica kanë pasur në total 470,583 banorë. Përderisa, numri i rasteve të pranuar lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe degët e saj në (Podujevë, Graçanicë, Lipjan, Gllgovc and Fushë Kosovë) për secilin vit ka shënuar rënie nga 3,677 raste në vitin 2021, në 1,795 raste në vitin 2022 dhe 970 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Prishtinës, numri i rasteve për paga jubilarë të pranuar në gjykatë tregon 743 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 363 raste në vitin 2022 dhe 196 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 125-ti qytetar nga rajoni i Prishtinës ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 275-ti qytetar i rajonit të Prishtinës ka parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 510-ti qytetar i rajonit të Prishtinës i është drejtuar gjykatës me padi për pagën jubilarë.



Grafika 9: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Prishtinës


Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 300-ti banor i rajonit të Prishtinës ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë.

5.2. Gjykata Themelore në Mitrovicë

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunat që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, që janë Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Leposaviq,

Zubin Potok, Zveçan, Skenderaj dhe Vushtrri kanë pasur në total 275,904 banorë. Përderisa, numri i rasteve të pranura lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj në (Leposaviq, Vushtrri, Zubin Potok, Skenderaj) për secilin vit ka shënuar ndryshime nga 1,302 raste në vitin 2021, në 427 raste në vitin 2022 dhe 1,216 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Mitrovicës, numri i rasteve për paga jubilarë të pranura në gjykatë tregon 472 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 155 raste në vitin 2022 dhe 441 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 212-ti qytetar nga rajoni i Mitrovicës ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 645-ti qytetar i rajonit të Mitrovicës ka parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 227-ti qytetar i rajonit të Mitrovicës i është drejtuar gjykatës me padi për pagën jubilarë.



Grafika 10: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Mitrovicës


Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 360-ti banor i rajonit të Mitrovicës ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë.

5.3. Gjykata Themelore në Pejë

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunitetet që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Pejë, që janë Peja, Deçan, Junik, Istog dhe Klinë kanë pasur në total 236,823 banorë.

Përderisa, numri i rasteve të pranuar lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Pejë dhe degët e saj në (Istog, Klinë dhe Deçan) për secilin vit ka shënuar rënie nga 590 raste në vitin 2021, në 296 raste në vitin 2022 dhe 140 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Pejës, numri i rasteve për paga jubilarë të pranuar në gjykatë tregon 249 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 125 raste në vitin 2022 dhe 59 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 402-ti qytetar nga rajoni i Pejës ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 800-ti qytetar i rajonit të Pejës ka parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 1,695-ti qytetar i rajonit të Pejës i është drejtuar gjykatës me Padi për pagën jubilarë



Grafika I I: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Pejës


Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 965-ti banorë i rajonit të Pejës ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë.

5.4. Gjykata Themelore në Prizren

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunat që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Prizren që janë Prizreni, Dragashi, Suhareka dhe Mamusha kanë pasur në total 331,620 banorë. Përderisa, numri i rasteve të pranuar lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët e saj në (Dragash dhe Suharekë) për secilin vit ka shënuar ndryshime nga 478 raste në vitin 2021, në 678 raste në vitin 2022 dhe 319 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Prizrenit, numri i rasteve për paga jubilarë të pranuar në gjykatë tregon 144 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 204 raste në vitin

2022 dhe 96 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 695-ti qytetar nga rajoni i Prizrenit ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 490-ti qytetar i rajonit të Prizrenit ka parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 1,042-ti qytetar i rajonit të Prizrenit i është drejtuar gjykatës me padi për pagën jubilarë.



Grafika 12: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Prizrenit


Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 740-ti banor i rajonit të Prizrenit ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë

5.5. Gjykata Themelore në Ferizaj

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunat që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Ferizaj që janë Ferizaj, Kaçaniku, Shtime, Shtërpcë dhe Hani i Elezit kanë pasur në total 185,695 banorë. Përderisa, numri i rasteve të pranura lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe degët e saj në (Kaçanik dhe Shtërpcë) për secilin vit ka shënuar ndryshime nga 956 raste në vitin 2021, në 114 raste në vitin 2022 dhe 231 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Ferizajt, numri i rasteve për paga jubilarë të pranura në gjykatë tregon 515 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 61 raste në vitin 2022 dhe 124 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 195-ti qytetar nga rajoni i Ferizajt ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 1640-ti qytetar i rajonit të Ferizajt ka

parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 807-ti qytetar i rajonit të Ferizajt i është drejtuar gjykatës me padi për pagën jubilarë




Grafika 13: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Ferizajt

Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 880-ti banor i rajonit të Ferizajt ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë

5.6. Gjykata Themelore në Gjilan

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunat që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan që janë Gjilani, Kamenica, Novobërda, Ranillugu, Vitia, Klllokoti dhe Vërboci, kanë pasur në total 181,459 banorë. Përderisa, numri i rasteve të pranuar lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe degët e saj në (Kamenicë, Viti dhe Novobërdë) për secilin vit ka shënuar ndryshime nga 825 raste në vitin 2021, në 207 raste në vitin 2022 dhe 1017 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Gjilanit, numri i rasteve për paga jubilarë të pranuar në gjykatë tregon 455 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 114 raste në vitin 2022 dhe 560 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 220-ti qytetar nga rajoni i Gjilanit ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 877-ti qytetar i rajonit të Gjilanit ka parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 179-ti qytetar i rajonit të Gjilanit i është drejtuar gjykatës me padi për pagën jubilarë.




Grafika 14: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Gjiilanit

Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 425-ti banor i rajonit të Gjiilanit ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë

5.7. Gjykata Themelore në Gjakovë

Përgjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023 sipas të dhënave të ASK, komunat që përbëjnë territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë që janë Gjakova, Malisheva dhe Rahoveci kanë pasur në total 196,867 banorë. Përderisa, numri i rasteve të pranuar lidhur me pagat jubilarë në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe degët e saj në (Malishevë dhe Rahovec) për secilin vit ka shënuar rënie nga 214 raste në vitin 2021, në 183 raste në vitin 2022 dhe 84 raste në vitin 2023.

Paraqitur në raport me 100.000 banorë në rajonin e Gjakovës, numri i rasteve për paga jubilarë të pranuar në gjykatë tregon 109 raste për 100.000 banorë në vitin 2021, 93 raste në vitin 2022 dhe 43 raste për 100.000 banorë për vitin 2023. Kjo nënkupton se në vitin 2021, përafërsisht çdo i 917-ti qytetar nga rajoni i Gjakovës ka parashtruar padi lidhur me rastet e pagës jubilarë. Pastaj në vitin 2022, afërsisht çdo i 1075-ti qytetar i rajonit të Gjakovës ka parashtruar padi të kësaj natyre, dhe gjatë vitit 2023 i bie se çdo i 1190-ti qytetar i rajonit të Gjakovës i është drejtuar gjykatës me padi për pagën jubilarë.



Grafika 15: Numri i rasteve të pagave jubilarë për 100,000 banorë të rajonit të Gjakovës

Në mesatare në tre vitet e fundit (2021, 2022, dhe 2023), afërsisht çdo i 1050-ti banor i rajonit të Gjakovës ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë.

6. Analiza e të dhënave të KGJK-së lidhur me rastet e pagave jubilarë

Në tre vitet e fundit, një numër i përgjithshëm prej 15,719 rasteve të pagave jubilarë është parashtruar pranë gjykatave në tërë Kosovën. Analiza është e bazuar në të dhënat e përpunuara dhe paraqitura nga KGJK.

Të dhënat e mëposhtme japin indikacionin se sa raste të pranuar në tre vitet e fundit janë trajtuar nga sistemi gjyqësor dhe sa prej tyre kanë filluar të trajtohen, të ndahen në punë te gjykatësit. Tutje, të dhënat po ashtu tregojnë për mënyrën e zgjidhjes së rasteve të pagave jubilarë, të cilat kanë marrë epilog në gjykatë. Për të vlerësuar nëse këto raste janë zgjidhur në gjykata apo ende janë në pritje për t'u trajtuar, në të dy rastet lidhur me statusin e lëndës dhe rezultatin janë përmbledhur dhe sqaruar më poshtë.

6.1. Statusi i lëndëve

Në bazën e të dhënave të KGJK-së, statusi i lëndëve është kategorizuar në tetë opsione të ndryshme: regjistruar, pranuar, caktuar, referuar për ndërmjetësim, zgjidhur, zgjidhur përmes ndërmjetësimit, apeluar, plotfuqishëm dhe arkivuar.

Statusi i lëndës	Numri i lëndës
Regjistruar	8076
Pranuar	32
Caktuar	12
Referuar në ndërmjetësim	11
Zgjidhur	4222
Zgjidhur përmes ndërmjetësimit	929
Apeluar	1921
Plotfuqishëm	79
Arkivuar	436
Nuk ka informacion	1
TOTAL	15 719


Tabela nr.1: Statusi i rasteve të pagave jubilarë gjatë periudhës kohore 2021 – 2023

Më qëllim të kuptimit të qartë se çka nënkupton secila fazë e procedurës gjyqësore të një rasti, IKD ka kontaktuar KGJK-në dhe ka pranuar sqarimet e mëposhtme:

- Regjistruar – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur kryhet hapi i fundit i regjistrimit të lëndës dhe caktohet gjyqtari.
- Pranuar – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur importohet një dokument dhe identifikohet lloji i lëndës dhe numri i lëndës.
- Caktuar – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur gjyqtari apo sekretarja juridike caktojnë seancë të shqyrtimit kryesor.
- Referuar në ndërmjetësim – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur gjyqtari apo bashkëpunëtori profesional referon lëndën në ndërmjetësim.
- Zgjidhur – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur përfundohet hapi i fundit i vendimit nga ana e gjyqtarit.
- Zgjidhur përmes ndërmjetësimit – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur përfundohet hapi i fundit i vendimit nga ana e gjyqtarit, të cilin vendim e ka marrë me rezultatin e përgjithshëm “zgjidhur përmes ndërmjetësimit”.
- Apeluar – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur importohet një ankesë dhe bartet në Gjykatën e Apelit.
- Plotfuqishëm – është status i cili sistemi SMIL i jep lëndës në momentin kur zyrtari përgjegjës në Gjykatë vendos klauzolën e plotfuqishmërisë së lëndës dhe posa të kryhet ky veprim në sistem, atëherë merret statusi “plotfuqishëm”.⁹

⁹ Përgjigjja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për IKD, përmes email-it me date:18.07.2024.

- Arkivuar – është statusi kur lënda është përfundimtare dhe rasti është dërguar për t'u arkivuar.



Grafika 16: Përqindja e statusit të rasteve të pagave jubilarë gjatë periudhës kohore 2021- 2023

Në bazë të të dhënave të siguruara nga KGJK, 5,666 nga 15,719 rastet e pagave jubilarë kanë përfunduar në tre vitet e fundit. Kjo nënkupton se mbi 35% e këtyre rasteve janë trajtuar dhe zgjidhur nga gjykatat nëpër Kosovë. Në anën tjetër, 8,076 raste vetëm janë regjistruar, pa ndonjë veprim tjetër të ndërmarrë nga gjykatat lidhur me këto raste. Si rezultat i kësaj, më shumë se 51% të rasteve të pranuar në tre vitet e fundit nuk janë marrë fare në shqyrtim nga gjykatësit apo nuk ka pasur ndonjë progres drejt zgjidhjes së tyre.

7. Analiza e aktgjykimeve në rastet e pagave jubilarë

Për qëllim të këtij raporti, IKD ka analizuar 30 aktgjykime në rastet e pagave jubilarë. Këto aktgjykime janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga faqet zyrtare të gjykatave dhe përfshijnë aktgjykimet e marra gjatë viteve 2021 – 2023.

Analiza do të ofrojë të dhëna lidhur me aspekte të ndryshme të trajtimit të lëndëve, përfshirë kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, rezultatit, nëse është kërkuar ndonjë ekspertizë gjatë procedurës gjyqësore, numri i rasteve kur avokati është caktuar nga ANJF, OJQ-të apo nëse avokati është angazhuar nga paditësi. Po ashtu, do të shqyrtojë vlerën monetare të kërkuar sipas padisë në raport me vlerën monetare të miratuar nga gjykata, si dhe nëse paditësi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve gjyqësore dhe vlerën e shpenzimeve të miratuar nga gjykata.


Analiza e 30 aktgjykimeve tregon se mesatarisht gjykatës i janë dashur 690 ditë apo gati dy vite për të vendosur lidhur me padinë nga koha kur është dorëzuar padia deri në kohën kur është marrë vendimi në shkallë të parë.

Nga 30 rastet e analizuara, IKD ka gjetur se paditë janë miratuar plotësisht në 21 raste, në katër raste ishin aprovuar pjesërisht dhe në pesë raste paditë ishin refuzuar.




Grafika 17: Aktgjykimet e analizuara nga IKD lidhur me rastet e pagave jubilarë.

Duke shqyrtuar nëse rastet e pagave jubilarë kanë pasur çfarëdo lloji të ekspertizës, analiza e IKD dëshmon se nga 30 rastet e analizuara, vetëm në një rast gjykata ka proceduar me ekspertizën financiare. Në 29 rastet tjera nuk ka përfshirë asnjë lloj të ekspertizave.



Grafika 18: Ekspertiza e kërkuar në rastet e pagave jubilarë të analizuar nga IKD


Për më tepër, IKD ka gjetur se në 30 rastet e analizuar, paditësit ishin të përfaqësuar nga avokati. Avokatet në këto raste ishin caktuar nga vet paditësit në baza private.



Grafika 19: Përfaqësimi i paditësit në gjykatë në rastet e pagave jubilarë të analizuar nga IKD

Gjatë analizimit të rasteve, IKD ka shqyrtuar poashtu edhe shpenzimet procedurale. Në bazë të ligjit për procedurën kontestimore (LPK), “Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor”.¹⁰ LPK përcakton se “Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit”.¹¹ Për më tepër, LPK urdhëron që “pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqfituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”.¹²

Në analizën e 30 rasteve, IKD ka gjetur se vetëm në një rast paditësi nuk kishte kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Përderisa në pesë raste të tjera padia është refuzuar, në bazë të LPK, gjykata ka vendosur se “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”.¹³ Në 24 rastet tjera, paditësi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale, të cilat kërkesa ishin aprovuar nga gjykata duke obliguar palën tjetër – gjithnjë institucionin shtetëror – që të mbulojë shpenzimet e tilla.



Grafika 20: Vendimet gjyqësore lidhur me shpenzimet procedurale në rastet e analizuar nga IKD

¹⁰ Ligji për Procedurën Kontestimore, Neni 449, par. 1.

¹¹ Po aty, par. 2.

¹² Po aty, neni 452.

¹³ Ligji për Procedurën Kontestimore, Neni 450.

8. Shpenzimet mesatare vjetore lidhur me rastet e pagave jubilarë

Nga analiza e rasteve rezulton se shuma mesatare e aprovuar për rastet e pagave jubilarë në një proces gjyqësor është afërsisht 1300 euro. Gjithashtu, kostot mesatare procedurale arrijnë në rreth 300 euro. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) përcakton lartësinë e kamatëvonesës tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.¹⁴

Bazuar në analizën e rasteve, shpenzimet mesatare për trajtimin e rasteve të pagave jubilarë janë llogaritur si më poshtë:

- Shuma mesatare e aprovuar në një padi është afërsisht 1,300 euro.
- Nga analiza rezulton se kohëzgjatja mesatare për zgjidhjen e një rasti në shkallë të parë është 2 vjet.
- Kostot mesatare procedurale arrijnë në rreth 300 euro.

Për të llogaritur vlerën në para, kamatëvonesa i shtohet 16% shumës së 1300 euro (8% për çdo vit për dy vjet), që arrin në 1508 euro. Shtohet edhe vlera e shpenzimeve procedurale prej 300 euro dhe rezulton në një kosto totale mesatare prej 1,808 euro për një rast pagash jubilarë. Duke pasur parasysh se gjykatat e Kosovës kanë pranuar 15,719 raste pagash jubilarë gjatë tre viteve të fundit, mesatarisht 5,240 lëndë në vit, shpenzimi mesatar total për këto raste është përafërsisht 9,473,920 euro në vit.



Ilustrimi I: Shpenzimet mesatare vjetore lidhur me rastet e pagave jubilarë.

Kjo nënkupton se shpenzimet vjetore të paguara nga shteti për paga jubilarë arrijnë deri në 10 milion Euro.

¹⁴ Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Neni 382.

9. Gjetje kryesore dhe konkluzionet:

- Ngarkesa e gjykatave ka pësuar luhajtje ndër vite për sa i përket numrit të rasteve të pagave jubilarë të pranuar brenda një viti kalendarik. Viti 2021 është karakteristik në kuptim të pranimit të rasteve të kësaj natyre. Ndryshe nga ky vit, në dy vitet pasuese 2022 dhe 2023, ka pasur rënie të numrit të rasteve të pagave jubilarë në krahasim me vitin 2021. Megjithatë, statistikat tregojnë një stabilitet të përgjithshëm të numrit të rasteve të pagave jubilarë, me vetëm një rritje të lehtë nga viti 2022 në 2023.
- Ka pasur një rënie të dukshme të rasteve të pagave jubilarë në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve civile në procedurë kontestimore gjatë tri viteve. Në vitin 2021, lëndët jubilarë përbënin 20% të numrit të përgjithshëm të çështjeve civile në procedurën kontestimore, që u ul në rreth 10% në vitin 2022 dhe 8% në vitin 2023.
- Mesatarisht në tre vitet e fundit, përafërsisht çdo i 300-ti banor i rajonit të Prishtinës ka iniciuar një padi në gjykatë lidhur me pagat jubilarë. Pasuar nga rajoni i Mitrovicës ku përafërsisht çdo i 360-ti banor ka iniciuar një padi të tillë. Në rajonin e Gjiçanit përafërsisht çdo i 425-ti banor ka iniciuar padi për pagë jubilarë, ndërsa në rajonin e Prizrenit përafërsisht çdo i 740-ti banor dhe në rajonin e Ferizajt përafërsisht çdo i 880-ti banor ka iniciuar padi. Në fund të listës qëndrojnë rajoni i Pejës me përafërsisht çdo 965-tin banor dhe rajoni i Gjakovës me afërsisht çdo 1050-tin banor që ka iniciuar padi në gjykatë për pagat jubilarë.
- Gjykatësve u janë dashur mesatarisht 690 ditë apo gati dy vite deri në vendosje meritore në shkallë të parë në këto raste.
- Vendimet në këto raste kanë treguar se padia është aprovuar plotësisht në 70% të rasteve, pjesërisht në 13% të rasteve, dhe janë refuzuar 17% të rasteve.
- Vetëm në një nga 30 rastet e analizuar është kërkuar ekspertizë financiare.
- Paditësit ishin përfaqësuar nga avokatët në të gjitha rastet. Avokatët ishin angazhuar dhe paguar nga vet paditësit.
- Në 80% të rasteve paditësit kishin kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale, të cilat gjykata i ka miratuar duke obliguar palën tjetër, gjithmonë institucionin shtetëror që të mbulojë shpenzimet e tilla.
- Kosto financiare të paguara nga institucionet shtetërore për pagat jubilarë arrijnë shumën deri në 10 milion Euro.

10.Rekomandimet

- Ministria e Financave, përmes Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, të ndajë buxhetin e nevojshëm për komunat, në mënyrë që rastet e pagave jubilarë të zgjidhen përmes rrugëve administrative, pa pasur nevojë të adresohen në gjykatë. Kjo do të mundësonte që ndarja e mjaftueshme e mjeteve buxhetore, të përmbushte kërkesat e qytetarëve drejtpërdrejt, duke reduktuar kështu numrin e kontesteve që rrisin numrin e rasteve në gjykata. Kjo mund të konsiderohet një qasje e përqendruar te qytetarët pasi fokusohet në nevojat dhe përvojat e individëve, në vend që thjesht të fokusohet në adresimin e tyre përmes institucioneve dhe procedurave ligjore.
- Gjykatat, pas pranimit të rasteve të pagave jubilarë duhet të informojmë paditësit lidhur me mundësinë e referimit të këtyre rasteve në ndërmjetësim si procedurë alternative e zgjidhjes së kontesteve.
- Avokatët mbrojtës që përfaqësojnë rastet e pagave jubilarë inkurajohen të iniciojnë zgjidhjen e këtyre rasteve përmes procedurës së ndërmjetësimit.

